



Belsh,më: . .2025

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM***(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Shpenzime per bileta te transportit ndërkombëtar”

LLOJI I PROCEDURES: Blerje Dinamike e Biletave për Transport Ajror

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Bileta transporti

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Belsh ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

Komisioni i Prokurimit me Vlere te Vogel në mbështetje të dispozitave ligjore sa më sipërcituar argumenton vendosjen e kriterëve si më poshte vijon:

Për realizimin e objektit të prokurimit Autoriteti Kontraktor kërkon nga Operoret ekonomik kur te paraqitet prane Autoritetit Kontraktor Bashkia Belsh të paraqesë dokumentat si më poshtë:

1. Të dhënat e plota të personit te kontaktit.
2. Nuk është në proces falimentimi, ekstrakt QKR historik/thjesht (statusi aktiv).

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të LPP, nenit 56 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".*

3. Ka paguar te gjitha detyrimet fiskale dhe sigurimet shoqërore të lëshuara nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve.
4. Një vërtetim që vërteton që ka likuiduar detyrimet me OSHE.

Argumentimi : Në zbatim të ligjit Nr. 87/2019 "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit", i ndryshuar

5. Operatori ekonomik duhet të ketë të përfshirë në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit në ftesën për ofertë.

6. Rezervimi i biletave

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të LPP, nenit 56 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore" i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, ne ligjin nr.131/2015 "Per QKB" i ndryshuar, si dhe ne ligjin nr.9723 date 03.05.2007 "Per QKR" i ndryshuar.

Bileta avioni:

Bileta avioni:

(1 person) Vajtje – Ardhje, bagazh 10kg:

Nisja: dt. **12.01.2025** nga Tirana (Albania) – Mbërritja në Perugia(Italy)

(Linjë direkt, ora e nisjes nga Tirana pas orës 08⁰⁰ dhe para orës 08³⁰ 12.01.2025)

Kthimi: dt.**14.01.2025** nga Bologna (Italy) – mbërritja ne Tiranë (Albania)

(Linjë direkt, ora e nisjes nga Bologna pas orës 08³⁰ dhe para orës 09⁰⁰ 14.01.2025)

(1 person) Vajtje – Ardhje, bagazh 32 kg:

Nisja: dt.**12.01.2025** nga Tirana (Albania) – Mbërritja në Perugia(Italy)

(Linjë direkt, ora e nisjes nga Tirana pas orës 08⁰⁰ dhe para orës 08³⁰ 12.01.2025)

Kthimi: dt.**17.01.2025** nga Bologna (Italy) – mbërritja ne Tiranë (Albania)

(Linjë direkt, ora e nisjes nga Bologna pas orës 15³⁰ dhe para orës 16⁰⁰ 17.01.2025)